

Paskajorja gege midis mohimit dhe integritit, realiteti gjuhësor

Haki Hysenaj

15 janar 2012

Përmbledhje

Rishikimi i standardit, përmirësimi dhe pasurimi i tij gjithnjë e më shumë po bëhen çështje diskutimesh ndër gjuhëtarët shqiptarë. Së fundi rekomandimet e Konferencës shkencore: *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit e të pasurimit të standardit*, mbajtur në Durrës, në fund të dhjetorit të vjetëm, në kuadër të këtij rishikimi, për herë të parë ka hapur perspektivën për integrimin edhe të paskajores gege *me + pjesorja* në gjuhën standarde. Ndonëse debatet ende janë për dhe kundër këtij integrimi realiteti gjuhësor dhe statusi i kësaj trajte foljore ndër folësit gegë, 39 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit, dëshmon se paskajorja *me + pjesorja* është aktive dhe ka tendencë gjithnjë më të mëdha për shtrirje në të gjitha stilet e ligjërimit, duke bërë kështu trysni direkte në standard.

Në këtë situatë, kur ekzistojnë debatet, në njërën anë dhe kur paskajorja gege bën këtë trysni për integrim, në anën tjetër, çështja e kësaj trajte foljore në këtë punim është shtruar në dy plane interpretimi. I pari është i karakterit sociolinguistik, që mëton të sqarojë "rezistencën" e kësaj trajte foljore ndaj aktit përjashtues, ndërsa i dyti, që është i karakterit gjuhësor, pretendon që përmes hulumtimit në terren të sqarojë dendurinë e përdorimit të dysorëve *me + punue* dhe *për të + punuar*, në mënyrë që të shihet se cila formë mbisundon në ligjërimet e folësve të standardit, që variatet të parë kanë gegërishten.

Objektivi i parë sjell rezultatit se paskajorja gege, e konsideruar si variacion dialektor, është ruajtur tek folësit gegë sepse identifikon një bashkësi të madhe, se është më ekonomike dhe më e lehtë për përdorim, ndërsa objektivi i dytë sqaron të dhënën jo të panjohur se paskajorja gege nuk është tërësisht e mbuluar nga trajta standard.

Për të mbërritur në rezultatet e prezantuara këtu kemi hulumtuar gjuhën e më-suesve të disa komunave të Kosovës, duke konsideruar se ata do të duhej të ishin autoritetet e para që me ligjërimin e tyre standard do të duhej të ndikonin në gjen-erata nxënësish për përvetësimin e standardit. Për krahasim kemi hulumtuar edhe gjuhën e studentëve të disa departamenteve të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës dhe disa emisione televizive. Rezultatet e hulumtimit dalin përafërsisht të njëjta te këto tri grupe informatorësh. Paskajorja gege mbisundon në ligjërimin formal e joformal të tyre.

1 Sfondi

Derisa teorikët pretendojnë se dialekti është gjithnjë nën tryshinë e gjuhës standard, rasti i paskajores gege i tipit *me punu (e)* sikur lëkund këtë konstatim. Tryshia e kësaj forme të pashtjelluar foljore për t'u bërë trajtë e koduar e standardit prodhon raporte të kundërta. Është pikërisht kjo njësi gjuhësore e dialektit gegë që në rastin e shqipes përmbyset në rendin e natyrshëm të këtyre raporteve kontaktuale me ndikim të natyrshëm standard-dialekt.

Dyzetë vjet pas standardizimit të shqipes kjo trajtë e pashtjelluar, ndonëse " e mbuar" me lidhoren toske të tipit *për të punuar*, në Kosovë vazhdon të përdoret gjithnjë e më shumë. Përdorimi i saj del në të dy trajtat e ligjërimit, me frekuenca jo të barabarta. Në trajtën e folur ajo tashmë del në të gjithë regjistrat e gjuhës së folësve gegë. Tendencat për shtrirjen e saj edhe në trajtën e shkruar janë në rritje. Përdorimi i trajtës *me punue* nga folësit gegë, pas gjithë kësaj jete të standardit përjashtues për paskajoren gege, siç u tha edhe një herë ka kohë që ka nxitur debate shkencore për dhe kundër integritet të saj në sistem. Megjithatë, në një situatë të këtillë, kur tryshia është shumë e madhe, duket se paskajorja gege po bëhet realitet i standardit. " Paskajorja po vjen në përdorim gojor të shqipes standarde, tash me trajtim si devijim nga standardi" (Bokshi, 2010:4).

Çështja integritet ose jo e paskajores në standard, si variant i lirë krahas lidhore të toske, është trajtuar nga shumë albanologë shqiptarë dhe të huaj. Shumica syresh mendojnë se *paskajorja gege* duhet të jetë pjesë e këtij standardi, duke arsyetuar këtë me argumentin se inkorporimi nuk shkakton lëkundje sistemi. Për më shumë argumentohet se pranimi i paskajores në standardin e shqipes vetëm sa begaton atë.

Në këtë situatë, pa pretenduar të përsërisim ato që janë thënë rreth paskajores gege, me këtë punim synojmë përshkrimin e realitetit gjuhësor të kësaj variacioni dialektor, i cili edhe përkundër mbetjes jashtë standardit ka denduri të madhe përdorimi. Mbi bazë të këtij hulumtimi, bërë me mësues shkollash fillore të disa komunave të Kosovës dhe studentë të UP-së, mund të thuhet se 39 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit paskajorja gege nuk është zëvendësuar me paskajoren e standardit. Ky realitet gjuhësor ta vë para dilemës nëse ky qëndrim i arsimtarëve ka ndikuar që paskajorja gege të bëjë jetën e vetë pavarësisht "përjashtimit" nga standardi dhe në anën tjetër të jetë faktor kryesor që kjo trajtë foljore, me status të këtillë, 40 vjet pas të ketë mbetur aktive në ligjërimet joformale dhe formale të përdoruesve të standardit nga folësit gegë, si në shkollë ashtu edhe në institucione të tjera publike.

Fillimisht hulumtimi është mbështetur në ligjërimin gojor dhe të shkruar të 70 mësuesve të ciklit të ulët dhe të lartë të disa shkollave fillore të komunave: Pejë, Gjakovë, Prizren, Klinë dhe Suharekë, të cilët vijnë nga rrafshet e riartësimit profesional në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë, në kuadër të një projekti qeveritar. Rezultatet kanë shtruar nevojën që korpusi të zgjerohet edhe me hulumtimin e gjuhës së studentëve të UP-së dhe të 2 televizioneve të vendit. Krahasimi reflekton rezultate të njëjta për dendurinë e kësaj trajte foljore.

2 Raportet kontaktuale standard-dialekt

Hudson lë pa përgjigje dilemën nëse është e drejtë të thuhet që i vetmi varietet që mund të konsiderohet si një "gjuhë e vërtetë" (në kuptimin e dytë të termit "gjuhë") është gjuha standarde. Megjithatë, duke i konsideruar ato me interes, sepse vendosin raporte të posaçme me shoqërinë, Hudson konstaton se *gjuhët standarde janë produkt i një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar nga ana e shoqërisë* (Hudson, 2002:43).

Në rastin e shqipes përzgjedhja e varietetit standard është bërë mbi bazë të përzierjes së dy varieteteve kryesore, toskërishtes dhe gegërishtes, me dominim të të parit. Mbetja jashtë standardit e paskajores gege, e cila dokumentohet të ketë qenë pjesë edhe e toskërishtes, *por e eliminuar nga preferenca e shprehjes me lidhore* (Shih: Bokshi, ibid.:1) është pikërisht produkt i kësaj ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar. Mbetja e paskajores jashtë standardit dhe realiteti i sotëm i përdorimit të saj dëshmon qartë se në sistemin morfologjik dhe sintaksor të shqipes standarde ka një zbrazëtim që plotësohet pikërisht nga kjo trajtë e pa standardizuar. Përdorimi i saj edhe 40 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit rrëzon mendimet se ajo del në trajtë sinonimike me paskajoren e standardit. Hulumtimet në terren, sado sipërfaqësore qofshin, përjashtojnë këtë konstatim të dhënë disa herë deri tashti në trajtesat për këtë formë foljore të gegërishtes. Paskajorja gege kryen shumë funksione që nuk mbulohen nga trajta toske, prandaj kemi gjithë këtë trysni të dialektit ndaj standardit për të pranuar në sistemin e tij këtë realitet. Ky ndërveprim nuk është aq i zakonitë për gjuhët e standardizuara. Si paskajorja jashtë standardit kanë mbetur edhe njësi të tjera të dialektit gegë, prandaj kemi ndonjëherë këtë rend të përmbysur në shqipe të raporteve standard-dialekt. Këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë qëndrim refuzues të gegëve ndaj standardit. Çështja është shumë më komplekse kur dihet se shqiptarët përtej kufirit të Republikës e Shqipërisë e kishin pranuar me entuziazëm standardizimin e gjuhës.

Për ekzistencën e paskajores në gjithë shqipen flasin edhe Jorgji Gjinari e Gjovalin Shkurtaç. *"Paskajorja si formë perifrastike e krijuar brenda shqipes gjatë zhvillimit historik të saj, ekziston në të dy dialektet, dallimet themelore shihen në mënyrat e ndryshme të ndërtimit të saj, dhe në masat e ndryshme të përdorimit nëpër dialekte"* (Gjinari-Shkurtaç, 2003:240). Po sipas këtyre dy autorëve në gegërishte paskajorja e formuar nga pjesëza përemërore *me* dhe nga pjesorja e foljes (*me punue*) kryen edhe shume funksione të lidhore (Gjinari-Shkurtaç.: ibid.:241).

Përligjjen e përdorimit të paskajores në shqipen standarde Ismajli e sheh si *"gjuhësisht të nevojshme"* (Ismajli, 2003:56), gjë që përforcon edhe më shumë mendimin për raportet e përmbysura kontaktuale standard-dialekt, gjë që në shqipe ka shkaktuar probleme komunikimi në një bashkësi të gjerë të identifikuar me variacionin e vet dialektor. Varieteti standard pretendon të përmbushë këto kërkesa, gjë që nun ka ndodhur tek pjesa dërmuese e kësaj bashkësie. Kjo përmbysje raportesh dhe mosplotësimi i kësaj kërkesë ka krijuar hapësirë për përdorim variacionesh dialektore, të cilat duke pasur frekuencë të madhe përdorimi sigurisht se do të integrohen në standard, madje edhe si variacioneve funksionale të varietetit dialektor.

Paskajorja gege e tipit *me punue* po shkon drejt këtij integrimi, duke i bërë gjithnjë e më shumë trysni standardit, që krahas lidhore toske të përdoret si variant i lirë, për

efekte gjuhësore, jo vetëm në trajtën e folur por edhe në të shkruar. Se është koha që kjo trajtë funksionale të përliqet edhe institucionalisht Veselaj shprehet: "...përliqja e përdorimit të paskajores me + pjesore si formë përfaqësuese, e arsyeshme dhe së këtejmi edhe me elemente të domosdosë, kriter ky i mjaftueshëm sa për të arsyetuar integrimin e paskajores me + pjesore në kuadër të strukturës së normës së shqipes standarde" (Veselaj, 2000:66).

Standardi, pra nuk është gjithmonë në përparësi ndikimi në varietetet që janë në kontakt. Në rastin e shqipes pos paskajores që bën këtë trysni të ngjashme bëjnë edhe njësi të tjera gjuhësore të varietetit gegë. Pa i përshkruar ato do të mjaftohemi duke përmendur gjatësinë e zanoreve si tipar funksional në varietetin standard të folësve gegë, rrafshimin e opozicioneve (Shih: Hysenaj, 2009:403), si dhe prurjet gjithnjë e më të mëdha në standard të leksemave të këtij varieteti. Duke përjashtuar rrafshimin e përmendur, që mendojmë se është duke ndodhur nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm gjuhësorë e jashtëgjuhësorë (Hysenaj, ibid.:403-408) gjithë njësitë e tjera të përkatësisë gege, që sot bëjnë trysni për t'u bërë pjesë e standardit, kanë gjetur zbrazëtira në të, njëjtë si paskajorja e përzgjedhur këtu për trajtim.

Dysorët brenda një gjuhe janë të lejueshëm. Kjo ndodh në shumë gjuhë të botës që kanë traditë të hershme shkrimi e standardizimi. E ato, sipas Ëilliam Bright, mund të studiohen në 3 dimensione, në dimensionin gjeografik, social dhe stilistik. "*Dimensioni gjeografik, duke qenë kryesori ka pushtuar vëmendjen e dialektologëve dhe si i tillë është paraqitur edhe në atlase dialektore. Llojet e tjera të variacioneve brenda gjuhëve u është kushtuar më pak vëmendje*" (Bright, 1990:11). Kjo duket të ketë ndodhur edhe në rastin e shqipes, prandaj "arsyetohet" planifikimi dhe ndërhyrja për gjuhën standard, duke lënë anash pasuri gramatikore e leksikore të varietetit gegë. "*Kërkesa e partisë-shtet për të standardizuar gjithçka përcaktonte edhe politikën gjuhësore*", shprehet Xhevat Lloshi, duke folur për nënstandardin e shqipes dhe marrëdhëniet e tij me shqipen standard (Lloshi, 1997:63).

Haguen, duke u mbështetur në qëndrimet e Ëolffram dhe Schilling, shprehet se bidialektizmi është më i vështirë për t'u përvetësuar se dygjuhësia. "*Të gjithë dijetarët kanë rënë në dakord se është e vështirë koekzistenca e dy gjuhëve të ngjashme (kupto varietete) aq sa e dy e partive shumë të ndryshme*" (Cituar sipas Jeff Siegel, 1998:287). Prandaj, paskajorja si variant i lirë në standard lehtëson këtë parim dhe ndihmon përvojën përvetësuese të standardit edhe ndër gegët.

Në fund të fundit paskajorja si edhe shumë njësi të tjera gjuhësore të gegërishtes, të mbetura jashtë standardit, kanë mbetur shtresime funksionale e territoriale me përdorim të dendur e shtrirje të gjerë në gjeografinë e shqipes. Padyshim se ato identifikohen qartazi si variacione, por që përdoren në gjuhën standarde të një pjese të madhe të bashkësisë dhe si të tilla kërkojnë vendin e tyre në gjuhën standard..

3 Realiteti gjuhësor

Një përvojë e re e mësimdhënies me mësues të moshës rreth 50-vjeçare na ka bindur për pozitën e qëndrueshme, në stile të ndryshme ligjërimiti, të paskajores gege në Kosovë.

Puna me arsimtarët e disa komunave të Kosovës, gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2010-2011, të cilët rikualifikohen në kuadër të një programi qeveritar në Gjakovë, është bërë kështu motiv për këtë punim. Në fakt ligjërimi i tyre i folur, në orët e ligjëratave dhe të ushtrimeve, ka reflektuar përdorime të variacioneve të ndryshme dialektore në kuadër të kodit të tyre ligjërimor. Ndër to paskajorja gege e tipit *me + pjesorja* ka paraqitur një interes të posaçëm hulumtimi, pasi që, siç u tha edhe në fillim, debatet rreth saj nuk kanë të ndalur, ndërkohë që realiteti i sotëm gjuhësor, sipas këtij hulumtimi, flet për një përdorim të qëndrueshëm e në rritje të kësaj trajte foljore. Ky realitet i regjistruar në ligjërimin e mësuesve, të cilët konsiderohen bartësit kryesorë të përvojave të zënies së standardit, na ka shtyrë të zgjerojmë numrin e informatorëve edhe me studentëve të rregullt të Universitetit të Prishtinës. Më pas, gjithnjë për krahasim, kemi hulumtuar edhe disa nga ligjërimet formale dhe joformale në masmediat tona. Rezultatet kanë reflektuar faktin se paskajorja gege përdoret gati në të gjitha stilet dhe domenet, prandaj duket se ajo po bëhet e pashmangshme dhe pjesë e standardit të folur, mbase edhe të shkruar, me ose pa aprovimin institucional. Kjo dëshmohet edhe për faktin se 40 vjet pas standardizimit të shqipes mësuesit në Kosovë, dhe për pasojë edhe gjeneratat e përgatitura prej tyre, përdorin këtë trajtë foljore si variacion dialektor në ligjërimin e tyre standard. Reduktimi i togut *-ue*, që është takuar në shumë raste, nuk cenon origjinalitetin e kësaj specie gege, e cila duket se jo vetëm i ka rezistuar mënjanimin, por përkundrazi i ka bërë trysni standardit për risistemim në funksionet e veta.

Arsimtarët e përzgjedhur rastësisht si informatorë kanë përdorur gjithnjë paskajoren gege *me + pjesorja*. Posaçërisht në ligjërimin e folur, në situata formale dhe joformale, d.m.th. edhe kur ligjërimi i tyre kushtëzohet nga situata dhe ambienti. Hulumtimi tregon se informatorët tanë e kanë përdorur këtë variacion dialektor gjithnjë në ligjërimet e tyre, duke bërë të kuptohet se pavarësisht pjekurisë së tyre profesionale me standardin ata e kanë ruajtur në ligjërimin e tyre, në trajtën e folur gjithsesi, paskajoren *me + pjesore*.

Mosha e informatorëve, 37 prej të cilëve mbajnë mësim në ciklin e ulët të arsimit fillor, e që do të thotë se në planet dhe programet e tyre me nxënës shpjegojnë njësi edhe nga gramatika e gjuhës shqipe dhe e 33 të tjerëve të ciklit të lartë, të drejtimit Informatikë-Teknologji, sillet nga 47-50 vjeç.

Përdorimi i kësaj trajte jostandarde, bazuar në hulumtimin tonë, nuk përcaktohet aq nga funksionet, qëllimet dhe domenet e situatat e përdorimit. Në fakt ky realitet shpjegon se këtu kemi të bëjmë me të dhënë se në Kosovë norma e gjuha standarde është imponuar më me pak sukses, prandaj variacioni gjuhësor është më i thellë. (Shih: Munishi, 2009:95). Kjo vlen në radhë të parë për shmangiet e folësve gegë nga standardi në disa fusha të shqipes, në radhë të parë në fonetikë dhe morfologji, ndërsa çështja e paskajores mbetet rast i veçantë.

Midis dy grupeve të informatorëve megjithatë ka ekzistuar një dallim fare minimal në përdorimin e paskajores. Derisa mësuesit e drejtimit Informatikë-Teknologji gjithnjë janë shprehur me këtë trajtë gege, grupi i mësuesve të ciklit klasor ka reflektuar paksa luhajtje. Pa bërë ndonjë përllogaritje, pasi që ligjërimi i tyre ishte spontan (informatorët nuk e dinin se gjuha e tyre po shndërrohet në objekt hulumtimi), në raste të veçanta mësuesit e ciklit klasor ndonjëherë kanë përdorur edhe trajtën e standardit të tipit për të punuar. Përqindja e përdorimit ka qenë minimale. Nga ana tjetër ne nuk kemi regjistruar asnjë

rast të përdorimit të paskajores *me + punuar* (pjesorja e toskërishtes), gjë e pritshme, pasi që standardi, sipas përvojave të gjuhëve të tjera, ndikon në eliminimin e variacionit dialektor. Rasti i paskajores gege ka dëshmuar të kundërtën. Këtu, siç është thënë edhe një herë, ndryshojnë raportet kontaktuale në favor të dialektit.

Përdorimi i paskajores gege është hulumtuar edhe në ligjërimin e folur të studentëve të Degës së Gjuhës Gjermane, Gjuhës Frënge dhe Orientalistikës. Rezultatet e këtij hulumtimi kanë dalë përafriht të njëjta me rezultatet e hulumtimit të ligjërimin të folur të mësuesve. Shumica e studentëve, në orët e ligjëratave dhe të ushtrimeve, në ligjërimin e folur kanë përdorur këtë variacion dialektor. Vetëm pas vërejtjes së po bënin shmangie nga standardi një pjesë e tyre kanë provuar të përdorin trajtën standarde të tipit *për të + pjesorja*, por gjatë rrjedhës së ligjërimin, pas disa fjalish, sërish kanë rrëshqitur në përdorimin e paskajores gege. Kjo gjendje ka treguar sa shumë është i ngulitur variacioni gegë i paskajores në ligjërimin e folur edhe te studentët.

Për të parë nëse vërtet paskajorja gege është tipike për të folurit formal të informatorëve tanë kemi bërë edhe hulumtimin e ligjërimin të tyre të shkruar. Së pari kemi korrigjuar testet e kalueshmërisë së provimit dhe më pas kemi kërkuar prej mësuesve dhe studentëve të shkruajnë nga një ese. Gjithnjë informatorët nuk kanë qenë në dijeni se ligjërimi i tyre po bëhej objekt i një hulumtimi shkencor, prandaj rezultatet mendojmë se janë të qëndrueshme.

Në testin e provimit mësuesit jo një herë kanë ngatërruar trajtën e paskajores gege me atë të standardit. Ndonëse situata del pak më e stabilizuar në përdorimin e paskajores së standardit, megjithatë nuk ka munguar edhe përdorimi i variacionit gegë. Situatë e njëjtë del edhe në testet e provimit të studentëve. Por gjendja ka ndryshuar në favor të paskajores gege kur është kërkuar që një tekst dialektor me tri raste të paskajores gege të shndërrohej në gjuhën standard. 70 për qind e të testuarve kanë ruajtur paskajoren *me + pjesore*, duke mos ditur ta zëvendësojnë me trajtën e standardit. Duhet sqaruar se edhe në këtë rast as mësuesit e as studentët nuk kanë qenë në dijeni se testimi do të përdorej për ndonjë hulumtim shkencor.

Pjesë të korpusit kemi pasur edhe hartimin e esëve. Temat kanë qenë të lira, si për mësuesit ashtu edhe për studentët. Në këtë tip teksti, që është letrar, nuk do mend se variacionet dialektore janë më të tolerueshme. *Autorët me përvojë e dinë se, herë-herë, duke shkelur udhëzimet konvencionale të gjuhës, mund të krijohen efekte të veçanta* (Rugova, 2006:79). Por, nisur nga premisa se informatorët nuk kanë aq formim teorik për këtë gjë, këtë mostër hulumtimi e kemi radhitur domethënëse për punimin tonë.

Rezultatet tregojnë se përpos paskajores standarde informatorët e kanë përdorur edhe paskajoren gege. Shembujt flasin për pasiguri përdorimi. Në të shkruar, megjithatë ka mbisunduar trajta *për të + pjesorja*.

Për përdorimin e paskajores gege nga mësuesit po sjellim disa nga shembujt më tipikë. *Me luftu duhej se armiku kishte zënë rob popullsinë civile. Ose me u dorëzu, ose me luftu, nuk kishte zgjidhje tjetër. Ne nuk shkuam me marrë, sepse nuk ia kishte bërë hyzmetin.*

Shembuj nga esetë e studentëve:

Sot duhet me punu shumë, sepse konkurrenca gëlltit njerëzit. Me lexu pandërprerë gjithçka arrihet.. Sot robotët munden me kry punën e specialistëve.

Në këto ese shpesh përdoret edhe trajta mohore e paskajores gege, e cila formohet me

pjesëzën *pa + pjesorja*, gjë që vë në dyshim konstatimet e ndonjë autori këtu te ne se edhe kjo trajtë është standardizuar plotësisht.

Përgjithësisht mund të thuhet se paskajorja gege ka një përdorim të dendur tek folësit që standardin e përdorin në stile formale dhe joformale. Posaçërisht në ligjërimin e folur, ndonëse rezultatet e hulumtimit tonë flasin për përdorim gjithnjë në rritje të kësaj trajte foljore edhe në ligjërimin e shkruar.

Paskajorja gege ka përdorim të dendur edhe në gjuhën masmediave tona. Pos edicioneve të lajmeve, në të gjitha emisionet e tjera të televizioneve kryesore në Kosovë paskajorja gege dominon përballë variacionit të standardit. . . . Shembuj:

Ata që duhet me ndërmarrë diçka..... (Klan Kosova, 11.05.2011). Me pas mundësi më shku me rregull në shkollë (KTV, 11.05.2011).

Shembujt e mësipërm dëshmojnë se paskajorja gege, në ligjërimet formale dhe joformale, në institucionet shkollore dhe masmediat tona del si variacion standard. Kjo më shumë ligjërimin e folur, në situata formale dhe joformale. Prandaj, shihet trysnia e kësaj trajte foljore që të jetë pjesë e sistemit të gjuhës standard. Po të kihen parasysh edhe funksionet e saja sintaksore, përkatësisht funksionet kundrinore, përcaktore, qëllimore dhe shpesh edhe kallëzuesore, si dhe efektet e saj stilistike në ligjërimin artistik, nuk do mend se integrimi i saj në standard është "nevojë gjuhësore".

Paskajorja *me + pjesorja*, bazuar në realitetin gjuhësor, duhet trajtuar si njësi që identifikon gjuhën gjithëkombëtare e jo vetëm varietetin letrar gegë. Kjo edhe për faktin se po kjo paskajore njihet përdorime të ndryshme edhe në toskërishte (Shih: Bokshi, ibid.:3), ndërsa për folësit gegë është më ekonomike dhe shumë më lehtë e më e përdorshme. Këtë e dëshmon rezultati i këtij punimi.

4 Përfundime

Në këtë punim paskajorja gege është hulumtuar në dy rrafshë. Përmes interpretimit teorik është konstatuar se kjo trajtë foljore gege është ruajtur në përdorim formal dhe joformal nga folësit gegë të standardit, pa ndryshuar trajtën e vet. Hulumtimi ka treguar se ka qenë funksionaliteti i pashuar ndonjëherë i këtij variacioni dialektor faktori kryesor që e ka mbajtur gjithmonë në përparësi përdorimi përballë trajtës së normuar toske.

Po ashtu ky interpretim ka vënë në diskutim çështjen e raportit kontaktual standard-dialekt. Në rastin e paskajores *me + pjesorja* gege rezultoi se standardi nuk ka arritur dot të shuajë variacionin e mbetur jashtë standardit, gjë e pritshme nëse bazohemi në praktikën e gjuhëve të standardizuara. Koegzistenca e dy paskajoreve, shpesh me funksione jo krejtësisht të njëjta, njëra standarde e tjetra e cilësuar si dialektore, 4 dhjetëvjetësha pas normimit të shqipes, në aspektin gjuhësor flet për mënjanim të pambuluar të një trajte foljore me një trajtë tjetër të njohur si standarde. Prandaj, ky rast dëshmon për raporte kontakti të përmbysura. Realiteti gjeografik dhe denduria e përdorimit e bëjnë të qëndrueshëm parimin se një variacion që ka shtrirje të gjerë gjeografike, kompaktësi ndërtimi dhe frekuencë të dendur përdorimi është element identifikues i një bashkësie, i cili vështirë se mund të mënjanohet nëse përzgjedhja për gjuhën standard nuk merr parasysh këto rrethana. Në rastin e paskajores gege këto parime janë mohuar, prandaj

kemi sot gjithë këtë trysni të dialektit mbi standardin.

Funksionaliteti dhe denduria përdoruese e kësaj trajte foljore është provuar edhe me analizat e bëra të ligjërimeve të folura e të shkruara të 70-të mësuesve të disa shkollave fillore të komunave të ndryshme të Kosovës. Ndonëse të gjithë të moshës 50- vjeçare, moment që ndërlidhet me aftësimin e tyre profesional në epokën e standardizimit të shqipes, në ligjërimin formal dhe joformal, posaçërisht në trajtën e folur, gjithnjë përdorin paskajoren gege. Përdorimi i saj edhe në të shkruar tashmë është evident. Si pasojë e këtij realiteti mendojmë të kemi sot aq funksionale paskajoren gege edhe në ligjërimet e studentëve dhe të moderatorëve e bashkëbiseduesve të tyre në masmediat tona.

Në këtë punim nuk jemi marrë me shpjegimin teorik dhe as me funksionet e paskajores gege. Kjo është bërë për faktin se në shqipe ka shumë studime serioze rreth kësaj trajte foljore. Gjithçka do të ishte jo më shumë se përsëritje.

Prandaj, me këtë punim vetëm kemi provuar të tregojmë realitetin gjuhësor dhe rendimentin funksional të paskajores gege në Kosovë. Besojmë e ia kemi arritur. Dhe për këtë punimin tonë: "Paskajorja gege midis mohimit dhe integritit, realiteti gjuhësor", kujtoj se më së miri do ta përmbyllim me konstatimin e akademikut Besim Bokshi: "Shqipja standarde e ka paskajoren e gegërishtes mundësi begatimi të shprehjes. Në rrugë të realizimit të kësaj mundësie duhet të ndihmohet, me u ndihmue duhet" (Bokshi, ibid.: 4).

REFERENCAT

1. Bokshi, Besim. (2010), "*Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe*", Konferenca shkencore: Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit e të pasurimit të standardit, Durrës, 15, 16 dhe 17 dhjetor 2010. [http://albanologjia.com/pdf/Konferenca 20 Shkencore20-20BESIM 20BOKSHI.pdf](http://albanologjia.com/pdf/Konferenca%20Shkencore20-20BESIM%20BOKSHI.pdf), më 15 prill 2011
2. Bright,Ëilliam. (1990), "*Language Variation in South Asia*", OXFORD UNIVERSITY PRESS, OXFORD.
3. Gjinari, Jorgji-Shkurtaç, Gjovalin. (2003), "*Dialektologji*", Universiteti i Tiranës, Tiranë.
4. Hysenaj, Haki. (2009), "*Kundërvënia fonologjike /r/-/R/, rrafshim dhe reflekse në gjuhën e folur dhe të shkruar*", Seminari për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, XXVIII/I, Prishtinë.
5. Hudson. A. Richard. (2002), "*Sociolinguistika*", Dituria, Tiranë.
6. Ismajli, Rexhep. (2003), "Standarde dhe identitete", Dukagjini, Pejë.
7. Lloshi, Xhevat. (1997), "*Mbështetje për gjuhën letrare*", Toena, Tiranë.
8. Munishi, Shkumbin. (2009), "*Variacioni gjuhësor në mediat audio-vizuele*", MEDIA, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
9. Rugova, Bardh. (2006), "*Gjuha e gazetave në Kosovë*" (disertacion i doktoratës), Prishtinë.
10. Siegel, Jeff. (2010), "*Second Dialect Acquisition*", CAMBRIDGE UNIVERSITY PRESS, NEË YORK.
11. Veselaj, Nuhi. (2000), "*Paskajorja çështje e shqipes standarde*", DARDANIA SACRA, Prishtinë.